



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 1132/6 Prot.

Patos, më 27.05 / 2024

PROCESVERBALI I TAKIMIT 24 MAJ 2024

Vendi: "Salla e mbledhejeve të këshillit të bashkisë Patos"

Ora e fillimit : 10:00

Ora e mbarimit : 12:00

Dëgjuesë publike me temë: "Miratimi i kriterëve dhe kushteve për licensimin e Agjencive të Shërbimit Funeral në bashkinë Patos"

Baza Ligjore: Në zbatim të ligjit me nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshar, Ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" si dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik", të ligjit nr. 9220, datë 29.10.2014 "Për administrimin e shërbimit të varrimit" i ndryshuar, vendimit nr. 402 datë 05.07.2023, për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 711 datë 29.10.2014, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë", si dhe kërkesës me nr. 1077/3 datë 25.04.2024, për licensimin e agjencive të shërbimit funeral në bashkinë Patos.

Pjesëmarrës: Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro, Kryetari i Këshillit të Bashkisë z. Armand Ahmeti Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Anëtarë të Këshillit të Bashkisë Patos, Kyetarë të fshatrave, dhe rreth 45 banorë të njësisive administrative Zharrëz, Ruzhdije, Patos dhe përfaqësues të shoqërive funerale qytetit.

Takimin hapet nga Kryetari i Këshillit: z. Armand Ahmetaj

Kryetar i Këshillit Bashkiak z. Armand Ahmetaj: të nderuar pjesëmarrës më lejoni së pari t'ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë takim konsultativ me temë: **“Miratimi i kriterëve dhe kushteve për licensimin e Agjencive të Shërbimit Funeral në bashkinë Patos”** i cili bazohet në të ligjit me nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshar, Ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” si dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, të ligjit nr. 9220, datë 29.10.2014 “Për administrimin e shërbimit të varrimit” i ndryshuar, vendimit nr. 402 datë 05.07.2023, për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 711 datë 29.10.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë”, si dhe kërkesës me nr. 1077/3 datë 25.04.2024, për licensimin e agjencive të shërbimit funeral në bashkinë Patos. Patjtër që kjo është një temë shumë e ndjeshme për të gjithë banorët najj si fillim ftoj ekzekutivin për paraqitje të materialit.

	<p>Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj</p> <p>Dëgjese Publike me temë :</p> <p><i>“Miratimi i kriterëve dhe kushteve për licensimin e Agjencive të Shërbimit Funeral në bashkinë Patos”</i></p> <p>Maj 2024</p>
--	---

Drejtores e Shërbimeve publike znj. Ermenita Mici: të nderuar pjesëmarrës në radhë të parë më lejoni tju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj. Ky takim realizohet në zbatim të vendimit nr. 402, datë 5.7.2023, për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 711, datë 29.10.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë” bashkive ju ka kaluar kompetenca për licensimin e shërbimeve funerale dhe /ose ofrimin e shërbimit për shtëpi funerale. Gjithashtu bashkisë i ka kaluar edhe e drejta për të hartuar kriteret dhe kushtet që duhet të plotësojnë agjencitë aktuale dhe ato që do të kërkojnë të licencohen në lidhje me kapacitetin teknik dhe

burimet njerëzore. Për hartimin e kriterëve është ngritur grupi i punës me specialist të fushës, ku komisioni pas studimit të nevojave për këtë shërbim specifik hartoi kriteret dhe kushtet për licensimin e agjencive të shërbimit funeral. Këto kriteret do të kalojnë për miratim në Këshilli i Bashkisë Patos, pas realizimit të kësaj dëgjese publike dhe konsultimit të tyre me grupet e interesit.

Drejtoresha e Shërbimeve Publike znj. Ermenita Mici: prezanton kriteret dhe kushtet për licensimin e Agjencive të Shërbimit Funeral në territorin e bashkisë Patos.



**Drejtoresha e Shërbimeve Publike
znj. Ermenita Mici**


Dëgjese Publike me temë :

***“Miratimi i kriterëve dhe kushtet për
licensimin e Agjencive të Shërbimit
Funeral në bashkinë Patos”***

Maj 2024

Kryetari i Bashkisë z. Armand Ahmetaj: faleminderit për informacionin tani fjala është për ju.

Kryetari i fshatit Dukas z. Ilmi Myfttari: - lidhur mbi varrezat e reja ka akoma shumë punë për tu bërë psh ka një problem të madh mbi parkimin e makinave. Rruga e varrezave dukas – Kuqar, të pastohen varrezat nga inertet dhe të ketë cesëm.



**Kryetari i fshatit Dukas
z. Ilmi Myfttari**

Dëgjese Publike me temë :

***“Miratimi i kriterëve dhe kushtet për
licensimin e Agjencive të Shërbimit
Funeral në bashkinë Patos”***

Maj 2024

Anëtar i Këshillit të Bashkisë z. Eduart Faslliaj – nga aministrata ka evidentim se sa varreza ka?

Kryetar i Bashkisë z. Fatjon Duro:- janë 47 varreza publike në të gjithë territorin e bashkisë

Anëtar i Këshillit të Bashkisë z. Eduart Faslliaj –në Margëllic janë një palë varreza ku nuk ka rrugë hyrëse dhe nuk pastrohen. Duhet të përcaktojmë disa kritere për hapsirën discancën edhe territorin pasi banesat iu janë afruar varrezave të fshatrave. Të pastrohen edhe mirëmbahen rrugët hyrëse edhe dalëse.



Anëtar i Këshillit të Bashkisë
z. Eduart Faslliaj

Dëgjesë Publike me temë :

*“Miratimi i kriterëve dhe kushteve për
licensimin e Agjencive të Shërbimit
Funeral në bashkinë Patos”*

Maj 2024

Banor i fshati Grizë z. Bardhyl Ruzhdija—në Grizë kërkoj që të bëhet shtrimi i rrugës te hangari si dhe bëhen urat e kalimit ndërsa lidhur me vendin vendin ku do të hapet varri ta përcakton fshati he kryetari i fshatit prandaj e kemi komunitetin të zgjedhur për punët e fshatit.



Banor i fshati Grizë
z. Bardhyl Ruzhdija

Dëgjesë Publike me temë :

*“Miratimi i kriterëve dhe kushteve për
licensimin e Agjencive të Shërbimit
Funeral në bashkinë Patos”*

Maj 2024

Banor i lagjes së Re z. Shpëtim Gjata: - Kam tre probleme për varrezat publike. Së pari, varreat uk janë të thurura, pastrimi bëhet sipas dëshirës dhe në shumë raste shohim se qivuret dëmtohen

nga njerëz të ndryshëm të cilët përveç dhimbjes që kemi na shtojnë edhe një dhimbje akoma më të madhe kur vemi tek të afërmit tanë dhe shohim qivuret e thyera dhe pastrimi i varreve të bëhet me ilaç.

	<p>Banor i lagjes së Re z. Shpëtim Gjata Dëgjesë Publike me temë :</p> <p><i>“Miratimi i kriterëve dhe kushteve për licensimin e Agjencive të Shërbimit Funeral në bashkinë Patos”</i></p> <p>Maj 2024</p>
---	--


Kryetari i fshati Sheqishte z. Bilbil Çepele: në fshatin sheqishte varrimi bëhet pa kriter, kanë rënë muret rethuese dhe kërkojmë që varrezat publike të kenë roje pasi dëmtohen varret dhe vidhen lulet

Kryetari i fshati Verbas z. z. Bilbil Çepele: në varrezat e verbasit varrimet bëhen pa kriter, zihen vende të cilat rezervohen nga banorët si dhe zihen rrugët hyrëse

	<p>Kryetari i fshati Verbas z. Bilbil Çepele Dëgjesë Publike me temë :</p> <p><i>“Miratimi i kriterëve dhe kushteve për licensimin e Agjencive të Shërbimit Funeral në bashkinë Patos”</i></p> <p>Maj 2024</p>
---	--

Banor i fshatit Dukas z. Enver Lamaj: - lidhur mbi varrezat publike keni bërë mirë që keni marrë këtë iniciativë për vendosjen e disa kriterëve për varrezat publike por unë doja të ngrija një shqetësim tjetër që ka të bëjë me rrugën e lagjes sime ku hidhen inerte, bëhen diegie masive të

gomave të makinave dhe mbi të gjitha mbeturinat hidhen nga makina e bardhë e bashkisë të cilat i shkarkojnë mbeturinat aty në atë gropë ku pak më poshtë është pika ku depozitohen inertet por nuk shkojnë atje



Banor i fshatit Dukas
z. Enver Lamaj

Dëgjesë Publike me temë :

*“Miratimi i kritereve dhe kushteve për
licensimin e Agjencive të Shërbimit
Funeral në bashkinë Patos”*

Maj 2024

Kryetar i këshillit Bshkiak z. Armand Ahmeaj:- bashkia e di këtë problem pasi edhe unë jam vet banor i dukasit por mos është ndonjë mjet jetër pasi bashkia nuk ka makinë të bardhë.

Banor i fshatit Dukas z. Enver Lamaj: - ne na ka mbatur vetëm të bllokjmë mjetin që të bindeni ju se është i bashkisë

Kryeari i Bashkisë z. Fation Duro:- jam në dijeni të problemit dhe po mendojmë ta mbyllim si rrugë me vendosjen e një trau për mos kalimin e mjeteve gjithsesi do të duhet ta shikojmë në vend.

Përfaqësues i shërbimit funeral “Bënca sh.p.k”, z. Pëllumb Bënca:-, përgëzoi bashkinë për nismën që keni marrë lidhur mbi këtë shërbim. Ne si subjekt që oftojmë shërbimin funeral në



Përfaqësues i shërbimit funeral “Bënca sh.p.k”
z. Pëllumb Bënca

Dëgjesë Publike me temë:

*“Miratimi i kritereve dhe kushteve për
licensimin e Agjencive të Shërbimit
Funeral në bashkinë Patos”*

Maj 2024

territorin e bashkisë Patos, kemi një problem lidhur mbi ofrimin e këtij shërbimi nga agjenci të tjera funerale, pasi marrja e këtij shërbimi është në dëshirën e palëve por këto agjenci pas kryerjes së procesit të punës si në hapjen e gropës apo edhe në vendosjen e qivureve nuk bëjnë pastrimin e terrenit apo heqjen e mbiturianve inerte dhe e gjithë kjo faturë qoftë edhe morale na faturohet ne.

Anëtar i Këshillit të Bashkisë z. Eduart Fasllija:- cdo kompani a paguan një tarifë ndaj bashkisë?

Drejtor e shërbimeve publike znj. Ermenita Mici: momentalisht jo

Anëtar i Këshillit të Bashkisë z. Eduart Fasllia:- mendoj që bashkia duhet të vendosi një tarifë me qëllim kontrollimin e punimeve nga agjencitë ose të varet nga bashkia ky shërbim, me qëllim kontrollimin dhe monitorimin e tyre



**Anëtar i Këshillit të Bashkisë
z. Eduart Fasllia**

Dëgjesë Publike me temë :

*“Miratimi i kriterëve dhe kushteve për
licensimin e Agjencive të Shërbimit
Funeral në bashkinë Patos”*

Maj 2024

Kryetar i fshatit Margëlliç z. Agron Faslliaj:- jemi dakort me ato që u thanë më lartë pasi varrezat publike janë të pasistemuara dhe shërbimi të kalojë në varësi të bashkisë pasi edhe kotrolli do të jetë më i lartë.



**Kryetar i fshatit Marëlliç
z. Agron Faslliaj**

Dëgjesë Publike me temë :

*“Miratimi i kriterëve dhe kushteve për
licensimin e Agjencive të Shërbimit
Funeral në bashkinë Patos”*

Maj 2024

Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro:- pas inspektimit të disa ditëve më parë më bëri përshtypje një fenomen lidhur mbi zënien e hapsirave për varre të cilat ishin të rezervuara dhe këto rezervine shkonin në 168 vende të zëna te parcela e re. Mbi gjykimin tim nuk është normale. Lihur mbi rrethimin dhe rrugët e brendëshme të varrëzave do të bëhen qysh këtë vit. Te varrezat e vjeta nuk mund të ndërhyjmë do vetëm me sistemimin e disa rrugicave atje ku ka mundësi. Të varrezat e reja do të bëhen rrugicat e kalimit si dhe do të përcaktohen përmasat standarte të qivureve si dhe rrugicat midis tyre. Hyrja kryesore e varrëzave zihet nga operatori që bën qivure



**Kryetari i Bashkisë
z. Fation Duro**

Dëgjesë Publike me temë :

*“Miratimi i kriterëve dhe kushteve për
licensimin e Agjencive të Shërbimit
Funeral në bashkinë Patos”*

Maj 2024

duke bërë llac dhe beton dhe në këto kushte kemi menduar që çdo operator që do të kryej shërbim duhet të marrë leje si për hapjen e varrit ashtu edhe për qivuret kurndrejt një pagese simbolike dhe kjo jo pa qëllim, por me qëllimin e saj kryesor dhe të vetëm kontrollimin e punimeve dhe në rast të koknstatimit të inerteve apo kryerjes së punimeve pa leje do të procedohet penalisht. Gjithashtu në varrezat publike për operatorët që kryejnë këtë shërbim do të përcaktohet një vend ku ata të bëjnë llac dhe beton. Lidhur mbi problematikën e rezervimit të vendit për mbajtjen dhe rezervimin e një vendi do të ketë një tarifë fikse. Lidhur mbi pastrimin e varrëzave për tharjen e barit me llac kemi patur kontestim me banorët ndaj pastrimi i tyre do të vazhdojë e mjet prerës

Anëtar i këshillit të Bashkisë z. Eduart Faslliaj:- mendoj se për rezervimin e një vendi në varrezat publike duhet të përcaktohet një afat kohor dhe një numër caktuar vendesh.

Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro:- lidhur mbi pastrimin e varrëve nuk mund të bëhet me llac pasi kemi patur ankesa nga qytetarët për tharjen e luleve natyrore ndaj pastrimi i tyre do të bëhet me mjet prerës.

Kryetari i Keshillit z.Armand Ahmetaj:- patjeter që kjo temë është mjaft delikate dhe me ngarkesë të lartë emocionale por mendoj se koha ishte e mjaftueshme për diskutime. Nëse ndokush nga të pranishit ka ndonjë gjë për të shtuar, komente apo sygjerime? Mqse jo e konsideroj këtë takim konsultativ të mbyllur. Edhe një herë faleminderit për pjesëmarrjen.

Konceptoi:

Koordinator i Konsultimit Publik


Suzana Hysenaj



Pranoi:

Sekretar i Këshillit

Refaela Xeba



Tema e Konsultimit: “Miratimi i kriterëve dhe kushteve për licensimin e Agjencive të Shërbimit Funeral në bashkinë Patos”

